

GRUPI



RAPORTI STATISTIKOR

JANAR - SHTATOR

2 0 2 2

Tabela e Përmbajtjes


Tregu i sigurimeve, Janar-Shtator 2022	1
Primet e Shkurara Bruto	1
Dëmet e Paguara	2
Grupi Eurosig – Insig, Janar-Shtator 2022	3
Prime të shkruara Bruto	3
Dëme të paguara	4

Tregu i sigurimeve, Janar-Shtator 2022

Primet e Shkurara Bruto

Tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë për nëntë mujorin janar-shtator të vitit 2022 ka shënuar rritje me rreth 9.46% krahasuar me periudhën janar-shtator 2021. Volumi i primeve të shkruara bruto ka arritur në vlerën 15,505,973,392 lekë. Struktura e tregut të sigurimeve vijon të mbetet e orientuar drejt sigurimeve të Jo Jetës, ku tregu i Jo Jetës zotëron 91.83% të tregut, ndërsa tregu i Jetës mban 8.08%, pjesa e veprimtarisë së risigurimit është afro 0.08% e totalit. Ndërkohë, numri i kontratave të lidhura rritet me 15.49%, duke arritur në 981,393 kontrata.

Grafiku 1: Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Shtator 2022



Burimi: AMF

Volumi i primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve gjatë nëntë mujorit janar-shtator të vitit 2022 shënon rritje me 9.46 % krahasuar me janar-shtator 2021.

Gjatë periudhës janar-shtator 2022, sigurimet e Jo Jetës shënojnë rritje me 8.55%.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës realizon 14,239,861,985 lekë prime të shkruara bruto, në rritje me 8.55% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Rritja vjen kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike, të cilat

përbëjnë afro 67.04% të totalit të primeve. Numri i kontratave të lidhura është në rritje me 14.76%, duke nënshkruar 889,014 kontrata.

Shënohet rënie me rreth 7.70% në vlerën e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve, mirëpo rritet numrin i dëmeve të paguara me 11.79%.


Dëmet e Paguara

Vlera e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve është 4,772,682,381 lekë, duke pësuar rënie me -7.70% krahasuar me vitin 2021. 90.21% e këtyre dëmeve të paguara janë nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.68% nga aktiviteti i Jetës dhe 5.11% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit. Nga aktiviteti i Jetës dhe Jo Jetës dëmet e paguara pësojnë rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ndërsa nga fondi i kompensimit vlera e dëmeve të paguara rritet me 23.73%.

Ndonëse është ulur vlera e dëmeve të paguara, tregu shënon rritje të numrit të dëmeve të paguara me 11.79%, duke u paguar kështu 43,903 dëme nga i gjithë tregut, ku 95.69% paguhen nga aktiviteti i Jo Jetës. Numri i dëmeve të paguara nga aktiviteti i Jo Jetës është 42,009 dëme në rritje me 11.45% krahasuar me janar-shtator 2021, ndërsa vlera e dëmeve të Jo Jetës rezulton 4,305,293,331 lekë, me 8.48% rënie.

Edhe tregu i sigurimeve të Jo-Jetës ka normë rënëse të pagesës së dëmeve, afro 8.48% më pak dëme të paguara se janar-shtator 2021.

Grafiku 2: Dëme të paguara tregu i sigurimeve, Janar-Shtator 2022



Burimi: AMF

Grupi Eurosig – Insig, Janar-Shtator 2022


Në grupin e sigurimeve Eurosig – Insig të trajtuara në këtë raport përfshihen shoqëritë Eurosig Shqipëri dhe Insig Jo Jetë.

Volumi i primeve të shkruara bruto të Grupit Eurosig – Insig shënon rritje me 9.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Prime të shkruara Bruto

Vlera e primeve të shkruara bruto të grupit për periudhën janar-shtator 2022 arrin në vlerën 2,858,507,443 lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, primet e realizuara të grupit janë në rritje me 9.29%, rritje pothuajse sa norma mesatare e tregut (afro 0.74% më shumë). Në tregun e Jo Jetës në Republikën e Shqipërisë grupi renditet në vendin e dytë në treg dhe zotëron 20.07% të totalit të primeve të shkruara bruto. Në të njëjtën linjë me tregun edhe grupi është i orientuara drejt sigurimeve të detyrueshme motorike, të cilat përbëjnë 83.92% të totalit, duke sjell një raport sigurimeve vullnetare me motorike të detyrueshme 15.80% me 84.20%. Ndërkohë, raporti vullnetare ndaj totalit të primeve të tregut për janar-shtator 2022 paraqitet 32.96%.

Grafiku 3: Përpjesa e shoqërive ndaj totalit të tregut



Burimi: AMF, përpunoi autori


Në tregun e sigurimeve të Jo Jetës në Republikën e Shqipërisë Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e dytë, duke zotëruar 20.07% të tregut të Jo Jetës.

Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e parë në treg në klasën e sigurimeve motorike, duke zotëruar 23.96% të tregut.

Rritja e përgjithshme e tregut të Jo Jetës është 8.55%, ndërkohë grupi rritet me 9.29%, rritje e ardhur kryesisht nga rritja e sigurimeve të detyrueshme motorike.

Nga sigurimet motorike, grupi Eurosig-Insig ka grumbulluar 2,512,824,411 lekë prime, renditur në vendin e parë në treg duke zotëruar 23.96% të tij. Totali i primeve motorike është në rritje me 14.77%, afro 3.29% më shumë se ritmi i rritjes së tregut, i cili rezulton 11.49%.

Grafiku 4: Struktura e tregut për sigurimin motorik, Janar-Shtator 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

Dëme të paguara

26.19% e primeve të Grupit Eurosig – Insig shkojnë për pagesën e dëmeve.

Vlera e dëmeve të paguara nga grupi Eurosig – Insig është 748,647,899 lekë, të cilat janë më rritje rreth 3.66% krahasuar me vitin 2021, ku ndërkohë tregu pëson rënie me afro -8.48% më pak se një vit më parë. Grupi rrit edhe numrin e dëmeve me 1.82% më shumë se nëntë mujori 2021. Raporti dëme/prime i grupit është 26.19%, ndërsa për tregun raporti rezulton afro 30.23%. Në totalin e dëmeve të paguara të tregut grupi Eurosig – Insig paguan 17.39% të tyre, renditur në vendin e tretë.


Grafiku 5: Dëme të pagura nga tregu i sigurimeve të Jo Jetës, Janar-Shtator 2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Nga klasa e sigurimeve motorike, grupi rrit vlerën e dëmeve të paguara me 33.00% më shumë se një vit më parë, ku ndërkohë tregu shënon rritje me vetëm 8.45%. Vlera e dëmeve të paguara për mbulimet e sigurimeve motorike është 679,112,828 lekë, duke e renditur grupin në vend të dytë.

Grafiku 6: Dëme të paguara për sigurimin motorik, Janar-Shtator 2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Grupi Eurosig-Insig shënon rritje me 3.66% në pagesën e dëmeve për janar-shtator 2022, krahasuar me 2021.

Norma e rritjes së pagesës së dëmeve të sigurimeve motorike është 24.55% më shumë se mesatarja e tregut.